



Data: 29/07/2019

Ref.: 1363/1990

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 73-të dhe 74-të, të mbajtur më 18.06.2019 dhe 15.07.2019, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet Kolegji Dardania në nivel institucional, për periudhën 01.10.2019 – 30.09.2022
- II. Riakreditohen programet e studimit:
 - Psikologji Aplikative dhe Studime Menaxheriale, BA, 180 ECTS, për periudhën 01.10.2019 – 30.09.2022, me nga 60 studentë për vit akademik.
 - Shkenca Politike dhe Administrim Publik, BA, 180 ECTS për periudhën 01.10.2019 – 30.09.2022, me nga 80 studentë për vit akademik.
 - Gjuhe Angleze dhe Studime Amerikane, BA, 180 ECTS, për periudhën 01.10.2019 – 30.09.2022, me nga 50 studentë për vit akademik.
 - Administrim Publik, MA, 120 ECTS për periudhën 01.10.2019 – 30.09.2022, me nga 80 studentë për vit akademik.
- III. Nuk riakreditohen programet e studimit:
 - Administrim Biznesi dhe Ekonomik, BA, 180 ECTS
 - Administrim Biznesi dhe Ekonomik, MA, 120 ECTS
- IV. Obligohet Kolegji Dardania që deri me datë 1 tetor 2019 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

I. Kolegji Dardania ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim institucional dhe të programeve të studimit të cekura në dispozitivin I të këtij vendimi.

AKA ka organizuar vizitën me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin Dardania më datë 21.05.2019 me qëllim të vlerësimit në nivelin institucional dhe të programeve të studimit me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit më këtë përbërje: Prof. Melita Kovacevic, Prof. Milan Pol, Dr. Yelena Istileulova

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 18.06.2019 dhe 15.07.2019 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit Dardania dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtar të dhënë në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në lidhje me riakreditimin institucional, raporti i ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit, konstaton se Kolegji Dardania përmbush në mënyrë substanciale standardet e akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit, prandaj rekomandon riakreditimin e këtij institucioni.

Në lidhje me programin e studimit Administrim Biznesi dhe Ekonomik, BA, 120 ECTS, raporti e ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit konstaton se ky program nuk i përmbush standardet e akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit, prandaj rekomandon mos akreditimin e këtij programi.

Në fushën e parë, misioni është dhënë në 4 forma të ndryshme :në raport të vetëvlerësimit ne dy versione, në web një version dhe në komentet e versionit të parë të raportit të ekspertëve dhe ekspertët nuk mund të dijnë cilin version ta marrin si të vlefshëm, Ekspertët e marrin si të vlefshëm versionin e parë që është dorëzuar në RVV, dhe aty ka vërejtje në formulim, si p.sh. në përsëritjen e fjalëve, mos përfshirjen e palëve të jashtme në formulimin e tij. Disa nga objektivat nuk janë të shkruara mirë, prandaj nuk janë të kuptueshme. Shumë informata lidhur me misionin e objektivat të cilat janë në ueb faqe, nuk janë të përditësuara, si dhe nuk janë identike në gjuhën shqipe dhe atë angleze.

Sa i përket kapitullit të dytë - menaxhimit të cilësisë, para së gjithash, ka mospërputhje për numrin e specializimeve të programit (diku figurojnë 4 e diku tjetër 5 specializime). Po ashtu ka mospërputhje ndërmjet titujve të programeve në ueb faqe dhe në RVV, gjë që shkakton huti lidhur me emërtimin e programit. Po ashtu brenda 5 strukturave të specializimeve të ndryshme për BA, ka disa dallime brenda strukturave të përmbajtjes së tyre të brendshme. Gjatë vizitës, stafi akademik nuk ka qenë në dijeni për Qendrën Kërkimore, sepse si duket ajo ekziston vetëm në letër. Edhe për këtë qendër ka mospërputhje lidhur me emërtimin dhe funksionin, nga burime të ndryshme nga kolegji. Janë vërejtur mospërputhje

edhe gjatë angazhimit të stafit akademik, të atij të ri dhe të vjetër, rolin e tyre në kolegji, dhe të drejtën për të qenë bartës të programit.

Në kapitullin e katërt, ku trajtohet përmbajtja e procesit arsimor, ekspertët vërejnë se stafi mësimdhënës ka nevojë të përfshihet më shumë në trajnime shtesë për metodat e ndryshme të mësimdhënies. Duhet të ketë më shumë sondazhe me punëdhënësit dhe marrjes së informatave nga ata me qëllim të përfshirjes dhe reflektimit të çështjeve të procesit arsimor. Po ashtu ekspertët vërejnë në syllabuset e disa lëndëve dhe në katalogun e kurseve nuk figurojnë “rezultatet e të nxënësve”, kualifikimet dhe kompetencat.

Sa i përket kapitullit të pestë – studentët, ekspertët kanë vërejtje se sa i përket studentëve, në RVV nuk ka mjaft informata. Mungojnë edhe informatat dhe analizat e kolegjit lidhur me numrin e studentëve që braktisin kolegjin dhe arsyet, si dhe për punësimin e studentëve. Sqarimi në RVV ka qenë se studentët kanë qenë të dobët, e kjo çështje ngrit një çështje tjetër, që është caktimi i kriterëve për pranimin e studentëve në kolegji. Është vërejtur edhe se puna praktike mbetet problematike, pavarësisht se ekzistojnë shërbimet e karrierës, si dhe ka rrezik dhe sfida në punësimin e të diplomuarve në tregun e punës.

Në lidhje me programin e studimit Administrim Biznesi dhe Ekonomik, MA, 120 ECTS, raporti e ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit konstaton se ky program nuk i përmbush standardet e akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit, prandaj rekomandon mos akreditimin e këtij programi.

Në kapitullin e parë, që është misioni, objektivat dhe administrimi, një vërejtje e ekspertëve është në formulimin dhe përdorimin e termave jo adekuat në deklaratën e misionit. Po ashtu, deklarata e misionit është mjaft e gjatë, dhe nuk përputhet me kriteret që ajo duhet të jetë e shkurtër, e qartë dhe koncize; është e rëndë për tu lexuar.

Kapitulli i dytë, i cili trajton menaxhimin e cilësisë, ka vërejtje si: në burime të ndryshme të raportimeve (ueb, ne gjuhen shqipe apo angleze), nuk përdoren njëjtë emrat e saktë të Departamenteve, Programeve, Specializimeve, Diplomave në procesin e Menaxhimit të Cilësisë; anëtarët e ekipit të sigurimit të cilësisë duhet të kontrollojnë syllabusin e programit me qëllim që ai të jetë i duhur në aspektin e cilësisë dhe numrave.


Në kapitullin e katërt, ku trajtohet përmbajtja e procesit arsimor, ekspertët vlerësojnë se mungon lista e kompetencave dhe aftësive, si në katalogun e kurseve ashtu edhe në shtojcat e katalogut. Po ashtu në këtë pjesë, analiza SWOT është bërë në mënyrë jo të duhur, e disa pjesë edhe nuk janë të përkthyer. Kapitulli i pestë trajton studentët, ekspertët kanë vërejtje se ky kapitull është më i shkurtër, dhe do të duhej të kishte shumë më shumë informata, duke marrë parasysh që studentët janë burimi kryesor i të ardhurave. Edhe pse në RVV thuhet se studentët kanë mbështetje të vazhdueshme për informimin për punësim dhe mundësitë për bursa dhe punë praktike, gjetjet janë se puna praktike mbetet problematike, dhe punësimi i të diplomuarve në tregun e punës është mjaft sfidues. Si program i nivelit master, studentët do të duhet të ishin më shumë të përfshirë në hulumtime, por për këtë nuk ka ndonjë provë.

Në kapitullin e gjashtë, në të cilin trajtohet hulumtimi, ekspertët vërejnë se ka disa paqartësi lidhur me llojet e aktiviteteve të cilat kryhen në Qendrën kërkimore të kolegjit, dhe se stafi akademik nuk ishte në dijeni për aktivitetet e kësaj qendre. Po ashtu, ekspertët kanë dilema rreth dy listave me punimet e publikuara në dy periudha të ndryshme kohore, sepse në to ka disa mospërputhshmëri.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit Dardania
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

